



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 4305 Prot.,

Tiranë më, 20 / 04 2018

URDHËR

NR. 188, DATË 20.04.2018

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË FEDERATËS SHQIPTARE TË KARATESË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 16 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Federatës Shqiptare të Karatesë, propozuar me Vendimin e Asamblesë, datë 22.12.2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (24 faqe).
2. Statuti ekzistues i Federatës Shqiptare të Karatesë, i miratuar në bazë të Ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për Sportin”, i shfuqizuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikolla



# STATUTI I FEDERATES SHQIPTARE TE KARATESE



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

## Tabela e Përmbajtjes

KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME.....	4
NENI 1 FORMA LIGJORE, PËRMBAJTJA, SELIA .....	4
NENI 2 STEMA DHE FLAMURI .....	4
NENI 3 QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA .....	5
KREU II ANËTARËSIA NË FSHK .....	6
NENI 4 ANËTARËT .....	6
NENI 5 ANËTARËSIMI .....	6
NENI 6 TË DREJTAT E ANËTARËVE.....	7
NENI 7 DETYRAT E ANËTARËVE.....	7
NENI 8 PEZULLIMI .....	8
NENI 9 HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT .....	9
NENI 10 DORËHEQJA E ANËTARIT.....	9
KREU III ORGANIZIMI.....	9
NENI 11 ORGANET E FEDERATËS SHQIPTARE TË KARATESË .....	9
NENI 12 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME.....	10
NENI 13 KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME .....	10
NENI 14 EMËRIMI I DELEGATËVE.....	11
NENI 15 NUMRI DHE PËRCAKTIMI I DELEGATËVE .....	11
KREU IV .....	12
NENI 16 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME .....	12
NENI 17 RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME .....	12
NENI 18 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME.....	13
NENI 19 VENDIM-MARRJA.....	13
NENI 20 DREJTIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME.....	14
NENI 21 ZGJEDHJET .....	14
KREU V.....	15
NENI 22 PRESIDENTI.....	15
NENI 23 DETYRAT E PRESIDENTIT .....	15
NENI 24 KOMITETI DREJTUES .....	15
NENI 25 KOHËZGJATJA E MANDATEVE .....	16
NENI 26 MBLEDHJET .....	16
NENI 27 KOMPETENCAT E KOMITETIT DREJTUES.....	17
NENI 28 KUORUMI DHE VENDIMARRJA.....	17



KREU VI	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM.....	18
NENI 29	SEKRETARI I PERGJITHSHEM.....	18
NENI 30	PËRJASHTIMI I NJË PERSONI TË ZGJEDHUR.....	19
KREU VII	FINANCAT.....	19
NENI 31	PERIUDHA FINANCIARE.....	19
NENI 32	BURIMET FINANCIARE, SPONSORIZIMET DHE REKLAMIMET.....	19
KREU VIII	SPORTISTI, KATEGORITË E SPORTISTËVE, TRAJNERI.....	20
NENI 33	SPORTISTI.....	20
NENI 34	KATEGORITË E SPORTISTËVE.....	20
NENI 35	STATUSI I SPORTISTIT TË NIVELIT TË LARTË.....	21
NENI 36	TRAJNERI.....	21
NENI 37	DETYRIMET E SPORTISTIT DHE TRAJNERIT.....	21
KREU IX	ANTIDOPINGU, KONTROLLI MJEKËSOR NË SPORT DHE SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE.....	22
NENI 38	PËRDORIMI I SUBSTANCAVE DHE METODAVE DOPING.....	22
NENI 39	DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME DOPINGUN.....	22
NENI 40	KONTROLLI MJEKËSOR NË SPORT.....	22
NENI 41	SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE.....	23
KREU X	DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË FUNDIT.....	23
NENI 42	DREJTESA SPORTIVE.....	23
NENI 43	DISPOZITA TE FUNDIT.....	23
NENI 44	HYRJA NË FUQI.....	24





# KREU I

## PARIME TË PËRGJITHSHME

### NENI 1

#### FORMA LIGJORE, PËRMBAJTJA, SELIA

1. Federata Shqiptare e Karatesë (në vijim do t'i referohemi si "FSHK"), është person juridik (i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas Vendimit Numër 3904 të datës 17 Qershor, 2014) i cili përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave sportive, shoqërive sportive dhe klubeve sportive të FSHK në Republikën e Shqipërisë, që vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin" (në vijim "**Ligji për Sportin**"), Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar (në vijim "**Kodi Civil**"), ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto aktivitete dhe që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë (në vijim "Legjislacioni në Fuqi").
2. Selia e saj ndodhet në qytetin e Tiranës. Adresa e FSHK është në Rr. "Dervish Hima", nr. 31. Ndryshimi i adresës së FSHK bëhet me vendim të Komitetit Drejtues të FSHK (referuar edhe si "**Komiteti Drejtues**" dhe/ose "**K.D**"), ndërsa vendimi për ndryshimin e selisë është i vlefshëm nëse votojnë pro 2/3 e anëtarëve të pranishëm në Asamblenë e Përgjithshme.
3. Jetëgjatësia e FSHK është me afat të papërcaktuar.

### NENI 2

#### STEMA DHE FLAMURI

1. FSHK ka stemën e vet që përbëhet nga: Flamuri Kombëtar me figurën e karateistit, sigla e FSHK, dhe viti 1991, që është viti i themelimit të shoqatës së parë të karatesë në Republikën e Shqipërisë (në vijim "**Stema e FSHK**").
2. FSHK ka flamurin e vet. Nga njëra anë me mbishkrimin "Federata Shqiptare e Karatesë" dhe Stemën e FSHK të fiksuar në të, ndërsa nga ana tjetër Flamurin Kombëtar.
3. Ajo ka vulën e vet në formë rrethore me shqiponjën dhe grushtin e stilizuar në mes dhe shkronjat AKF (Albanian Karate Federation), si dhe shkrimin Federata Shqiptare e Karatesë rreth vulës.



4. Asnjë person, apo entitet tjetër, anëtar ose jo i FSHK nuk mund të përdorë Stemën e FSHK, flamurin dhe vulën e saj, për çfarëdolloj arsye, pa miratimin paraprak të Komitetit Drejtues të FSHK dhe të firmosur nga Presidenti i saj.
5. Vendimi për ndryshimin e Stemës së FSHK, flamurit dhe vulës së saj, është i vlefshëm nëse votojnë pro 2/3 e anëtarëve të pranishëm në Asamblenë e Përgjithshme.

### NENI 3 QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA

1. FSHK është organizatë sportive jofitimprurëse. Të ardhurat që gjeneron FSHK nga burime të ndryshme ligjore ri-investohen 100% për zhvillimin e aktiviteteve të FSHK.
2. FSHK ka këto objektiva dhe detyra:
  - a) Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë ushtrimin e veprimtarisë sportive në sportin e Karatesë të të gjitha stileve (duke përfshirë por pa u kufizuar në Shotokan, Shito-Ryu, Wado-Ryu, Goju-Tyu, Koykushin, Uechi-Tyu, Shorin-Ryu, Kempo etj) në nivel kombëtar, duke u përpjekur për krijimin e kushteve optimale për ushtrimin e Karatesë, në përputhje me Legjislacionin në Fuqi.
  - b) Të ndihmojë në zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve profesionale midis anëtarëve të FSHK, si dhe të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, bazuar në Statut, rregulloret e saj, Legjislacionin në Fuqi, si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë në sportin e Karatesë.
  - c) Të organizojë, drejtojë, kontrollojë dhe të mbikqyrë aktivitetet në sportin e Karatesë për të gjithë grup-moshat, gjinitë dhe peshat, në nivel lokal, kombëtar, si dhe ndërkombëtar (këto të fundit, me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin). Aktivitetet sportive përcaktohen në kalendarët përkatëse nga Komiteti Drejtues dhe miratohen në Asamblenë e Përgjithshme. Kufijtë e moshave dhe peshave përkatëse përcaktohen në rregulloren e brendshme të FSHK.
  - ç) Të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “Kampionin Kombëtar” dhe “Ekipin Kampion Kombëtar” në sportin e Karatesë dhe disiplinat përkatëse.
  - d) Të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “Fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin e Karatesë dhe disiplinat përkatëse.
  - dh) Të japë titujt sportivë, brezat, kategoritë sportive e të tjera të këtij lloji.
  - e) Të aderojë në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar.
  - ë) Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në federatat ndërkombëtare përkatëse të Karatesë.





f) Të organizojë ekipet kombëtare të të gjitha kategorive si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari.

g) Të organizojë veprimtari sportive ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e vet, me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin.

gj) Të licensojë trajnerë, gjyqtarë dhe specialistë të tjerë për sportin e Karatesë.

h) Të koordinojë dhe japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive dhe garave sportive për anëtarët e saj.

## KREU II ANËTARËSIA NË FSHK

### NENI 4 ANËTARËT

1. Anëtarët e FSHK mund të jenë persona juridikë që janë klube sportive, shoqata sportive apo shoqëri sportive, të cilat janë të regjistruar në gjykatë, dhe paraqisin dokumentat e përcaktuara nga FSHK dhe që pranojnë aderimin pranë saj, duke respektuar statusin dhe rregulloret e funksionimit të FSHK.
2. Anëtarët e regjistruar të FSHK janë të detyruar të kontribuojnë për FSHK nëpërmjet pagesës të kuotizacioneve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Selia e anëtarëve të FSHK duhet të jetë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Anëtarët e FSHK kanë të drejtë të vihen në dijeni për të gjithë vendimet dhe veprimtaritë sportive të FSHK. Njoftimi në këto raste kryhet nëpërmjet dërgimit të një njoftimi nga organet e FSHK-së.

### NENI 5 ANËTARËSIMI

1. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, klubi sportiv, shoqëria sportive ose shoqata sportive mund të kërkojë të drejtën e anëtarësimit pranë FSHK.
2. Pas verifikimit të dokumentacionit dhe përmbushjes së kriterëve përkatëse, Komiteti Drejtues i FSHK i jep kërkesit të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHK. Anëtar i provizor i FSHK-së ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga FSHK, po nuk ka të



drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme deri në aprovimin e statusit të tij si anëtar i plotë nga Asambleja e Përgjithshme. Një anëtar provizor nuk mund të konsiderohet për anëtarësi të plotë deri në momentin që ka marrë pjesë për dy vite rresht në aktivitetet kombëtare të organizuara nga FSHK.

3. Asambleja e Përgjithshme e FSHK vendos mbi anëtarësinë e një anëtari provizor, pasi ai ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Brendshme të FSHK. Asambleja e Përgjithshme nuk mund ta refuzojë atë, për sa kohë kërkesa është në përputhje me Statutin dhe rregulloret e FSHK.
4. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme duhet të jetë i arsyetuar. Kundër vendimit për anëtarësim mund të paraqitet ankim pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS).

## NENI 6 TË DREJTAT E ANËTARËVE

Anëtari i FSHK ka të drejtë:

1. Të pajiset me kartën e antarësimit;
2. Të pajiset me Statutin dhe rregulloret e FSHK;
3. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme sipas kriterit një anëtar një votë;
4. Të vihet në djeni mbi vendimet e Komitetit Drejtues të FSHK;
5. Të pajiset pa pagesë me botimet e ndryshme që mund të bëjë FSHK;
6. Të marrë pjesë në aktivitete zyrtare e miqësore, kombëtare e ndërkombëtare që organizon FSHK.
7. Të njihet paraprakisht me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.

## NENI 7 DETYRAT E ANËTARËVE

1. Të ketë një sjellje korrekte ndaj FSHK, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHK dhe në kundërshtim me vendimet e organeve të saj.
2. Të paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj FSHK, përfshirë licensimet e ekipeve, brenda afateve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues. Anëtarët që kryejnë licensimet pas afatit të përcaktuar nga Komiteti Drejtues, por brenda një muaji nga kalimi i këtij afati, mund ta bëjnë këtë duke paguar penaltitetet e përcaktuara nga rregullorja e brendshme e FSHK. Në të gjitha rastet, asnjë ekip sportiv nuk mund të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga FSHK pa kryer më parë pajisjet me licensimet e nevojshme.





3. T'i komunikojë FSHK çdo ndryshim në Statutet dhe rregulloret e anëtarësimit, si dhe listën e personave ose zyrtarëve të tyre që kanë të drejtë përfaqësimi në marrëveshje ligjore me palët e treta.
4. Të pranojë dhe t'u nënshtrohet Statutit dhe rregulloreve të FSHK dhe institucioneve ndërkombëtare.
5. Të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe nëse e gjykon të arsyeshme dhe organin disiplinor për Asamblenë e Përgjithshme.
6. Të njohë parimet e ndershmërisë, *fair play*-it, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
7. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera si rrjedhojë e Statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHK.
8. Të marrë pjesë të paktën çdo vit, në Kampionatin Kombëtar dhe Kupën e Republikës (në vijim "Aktivitetet Bazë"), si dhe në aktivitetet e tjera të organizuara nga FSHK. Të mos lejojë asnjë person të marrë pjesë në asnjë veprimtari sportive të karatesë, pa u anëtarësuar më parë pranë FSHK.

## NENI 8 PEZULLIMI

1. Shkelja e rënde e Statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHK i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHK për një periudhë, e cila do të parashikohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Në rastet që e gjykon të përshtatshme, Komiteti Drejtues mund të japë pezullim provizor deri në Asamblenë në vijim, e cila do të shprehet mbi vendimin e Komitetit Drejtues. Situatat që sjellin si pasojë pezullimin e anëtarit përfshijnë, pa u kufizuar në, moskryerjen e licensimeve të sportistëve/ekipeve brenda afateve të përcaktuara, apo mospjesëmarrja e një ekipi të paktën në Aktivitetet Bazë.
3. Çdo vendim për pezullim sjell si pasojë humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit, për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi, deri në asamblenë tjetër të radhës, ku anëtari duhet të pranohet rishtazi nga Asambleja e Përgjithshme.



**NENI 9**  
**HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT**

1. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit nga FSHK.
2. Anëtarët e FSHK që kanë kryer licensimet por nuk marrin pjesë në Aktivitet Bazë gjatë një viti, e humbin të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme të rradhës. Nëse në vitin vijues anëtari kryen licensimet dhe merr pjesë në Aktivitetet Bazë, ai e rifiton të drejtën e votës pa pasur nevojë të riaplikojë për anëtarësim.
3. Anëtari që nuk ka kryer licensimet për dy vite rresht apo, edhe nëse ka kryer licensimet, nuk ka marrë pjesë për dy vite rresht në Aktivitetet Bazë, humbet plotësisht statusin e anëtarit dhe duhet të riaplikojë për anëtarësim.
4. Humbja e statusit të anëtarit nuk e shkarkon atë nga detyrimet financiare të papërbushura kundrejt FSHK.

**NENI 10**  
**DORËHEQJA E ANËTARIT**

Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje. Kërkesa duhet të paraqitet Komitetit Drejtues të paktën 30-ditë para datës kur dëshirohet që dorëheqja të marrë efekt.

**KREU III**  
**ORGANIZIMI**

**NENI 11**  
**ORGANET E FEDERATËS SHQIPTARE TË KARATESË**

1. Organet e FSHK, janë :
  - a) Asambleja e Përgjithshme.
  - b) Presidenti.
  - c) Komiteti Drejtues.
2. Komisionet janë :
  - a) Komisioni i Disiplinës.
  - b) Komisioni i Financës.
  - c) Kolegjumi Qendror i gjyqtarëve.



d) Komisione të tjera (në varësi me numrin e anëtarëve dhe nevojat e Federatës).

## NENI 12 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Federatës Shqiptare të Karatesë. Vetëm një Asamble e Përgjithshme e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij Statuti, ka autoritet të marrë vendime. Rendi i ditës dhe mënyra e organizimit të mbledhjes përcaktojnë nëse asambleja do të jetë e zakonshme, zgjedhore dhe e jashtëzakonshme.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj, të cilët përfaqësohen me 1 (një) votë. Një delegat mund të përfaqësojë vetëm një anëtar.
3. Mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë vote, anëtarët me të drejta provizore, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, anëtarët e Komitetit Drejtues, Sekretari i Përgjithshëm i FSHK, përfaqësues të Ministrisë së Sporteve apo të Komitetit Olimpik Shqiptar.
4. Komiteti Drejtues vendos për pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Këta persona nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me lejen e drejtuesit të Asamblesë së Përgjithshme.

## NENI 13 KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

1. Miraton ndryshime të Statutit të FSHK, në përputhje me Ligjin për Sportin.
2. Miraton pasqyrat financiare të FSHK.
3. Miraton raportin vjetor të Komitetit Drejtues të FSHK.
4. Voton mbi buxhetin e FSHK.
5. Miraton organin e mbikqyrjes financiare të pavarur nga FSHK, sipas Legjislacionit në fuqi.
6. Përcakton numurin e plotë të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
7. Zgjedh Presidentin e FSHK.
8. Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues.
9. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënien e titujve të nderit, brenda juridiksionit të FSHK.





10. Miraton pranimin, pezullimin, pushimin apo dorëheqjen e një anëtari, sipas parashikimeve në këtë Statut.
11. Revokon mandatin e një anëtari apo të organeve të FSHK, sipas parashikimit në këtë Statut.
12. Deklaron shpërndarjen e FSHK dhe likuidimin e masës së falimentit.
13. Miraton kalendarin e aktiviteteve të aprovuara nga Komiteti Drejtues.

#### NENI 14 EMËRIMI I DELEGATËVE

1. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHK janë të detyruar të mbledhin Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, klubit, shoqërisë sportive etj., për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHK.
2. Anëtarët (klubet, shoqatat, shoqëritë sportive etj.) dërgojnë pranë FSHK personat e autorizuar për përfaqësimin e tyre.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës, klubit sportiv, shoqërisë sportive etj., që vërteton se ai është përfaqësues me të drejtë vote.
4. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë personale).
5. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtari tjetër.
6. Anëtarët (klubet, shoqatat apo shoqëritë sportive) janë të detyruar të paraqesin emrat e personave të autorizuar për t'u përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë Sekretariatit të FSHK, jo më vonë se 20-ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme.

#### NENI 15 NUMRI DHE PËRCAKTIMI I DELEGATËVE

1. Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:

a) Çdo Klub sportiv ka	1 (një) delegat.
b) Çdo Shoqatë sportive ka	1 (një) delegat.
c) Çdo Shoqëri sportive ka	1 (një) delegat.
2. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.





## KREU IV

### NENI 16

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e FSHK thirret nga Komiteti Drejtues dhe mbledhet një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30-ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga Komiteti Drejtues. Rendi i ditës, raportimi i aktiviteteve, buxheti, pasqyrat financiare dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohet anëtarëve të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë çështje të cilat i mendon të arsyeshme për tu përfshirë në rendin e ditës. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në Sekretariatit e FSHK, të paktën 7 ditë përpara mbledhjes.

### NENI 17

#### RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME

1. Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:
  - a) Verifikimi i përbërjes së mbledhjes.
  - b) Raporti i Presidentit.
  - c) Miratimi i raportit të aktiviteteve të Komitetit Drejtues të F.SH.K.
  - d) Miratimi raportit financiar.
  - e) Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
  - f) Zgjedhje për çdo vend vakant.
  - g) Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në Statutin e FSHK.
  - h) Detyrat e FSHK dhe Kalendarin e aktiviteteve për vitin pasardhës.
  - i) Antarësimet e reja dhe përjashtimet nga Federata (nëse ka).
  - j) Vendimet e rëndësishme të Komitetit Drejtues, gjatë periudhës ndërmjet dy Asambleve.
  - k) Çështje të tjera, që futen në rendin e ditës, me kërkesë të antarëve.
2. Rendi i ditës mund të amendohet nga një mazhorancë që përbën 2/3 e votave para fillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme.



**NENI 18**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME**

1. Komiteti Drejtues mund të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 1/3 e delegatëve të FSHK bëjnë një kërkesë me shkrim, Komiteti Drejtues është i detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse kjo asamble nuk mbahet, anëtarët që e kërkuan atë, mund ta thërrasin vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune.
3. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara datës së mbledhjes.
4. Rendi i ditës, si dhe çdo dokument tjetër, duhet t'u dërgohet anëtarëve 10-ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Komiteti Drejtues vendos për rendin e ditës, kur Asamblenë e thërret ai. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 së delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.

**NENI 19**  
**VENDIM-MARRJA**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezentë 50% + 1 të delegatëve me të drejtë vote, me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50% + 1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të mbahet 24 orë pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë, përveç kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në Statutin e FSHK, si zgjedhja e Presidentit dhe e K.D., lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të FSHK, përjashtimi i një anëtar të FSHK, për të cilën kërkohet një mazhorancë prej 2/3 e votave nga votimi i delegatëve prezentë.
3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Anëtarët ushtrojnë të drejtën e votimit të tyre përmes delegatëve të tyre zyrtarë. Një delegat nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.
5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese kur votimi është i hapur.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.





7. Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme hyjnë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë K.D.

## NENI 20 DREJTIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga zëvendës-presidenti. Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër i Komitetit Drejtues, duke u emëruar Kryetar i ditës.
2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave, me jo më pak se 3 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për zbatimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për të diskutuar mbi rendin e ditës.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 20-ditëve mbas datës së mbledhjes.

## NENI 21 ZGJEDHJET

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet (me përjashtim të Presidentit) duhet të bëhen mbi bazën e 50% + 1 të votave të delegatëve prezentë në raundin e parë dhe pastaj në bazë të një numri më të madh të votave në raundin e dytë. Në rast se votat janë të njëjta, bëhet një raund tjetër për të ndarë kandidatët, i cili përsëritet jo më shumë se tre herë. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e Presidentit të FSHK ka nevojë për 2/3 e votave të delegatëve prezentë në mbledhje. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin 2/3, atëherë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh në raundin e parë kualifikohen për raundin tjetër. Në raundin tjetër, kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë, atëherë zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 2.
4. Çdo kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i FSHK, jo më vonë se 20-ditë para datës së Asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e Komitetit Drejtues.  
Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme.



## KREU V

### NENI 22 PRESIDENTI

Kandidati për President duhet:

1. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
2. Të ketë arsim të lartë;
3. Të ketë figurë të pastër morale;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja; si dhe
5. Të ketë kontribuar në menyrë thelbësore në sferën e sportit në një prej fushave në vijim: si sportist, trajner, gjyqtar, gazetar sportiv apo donator.

### NENI 23 DETYRAT E PRESIDENTIT

Detyrat e Presidentit janë:

1. Të përfaqësojë FSHK si i vetmi përfaqësues i saj;
2. Të kërkojë thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme si dhe të thërrasë mbledhjet e Komitetit Drejtues;
3. Të drejtojë punimet e Asamblesë së Përgjithshme ,po ashtu dhe mbledhjet e Komitetit Drejtues;
4. Të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues;
5. Në rast se Presidenti mungon, detyrat mund t'i ngarkohen zv/presidentit;
6. Në rast kur Presidenti jep dorëheqjen, Komiteti Drejtues cakton zv/presidentin që do të kryejë funksionet e Presidentit përkohësisht, deri në mbledhjen urgjente të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

### NENI 24 KOMITETI DREJTUES

1. Komiteti Drejtues (K.D.) është organ vendimarrës dhe drejtues i FSHK i përhershëm për periudhën midis dy asambleve.
2. Ai përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë me këtë strukturë: Presidenti dhe 6 anëtarë.
  - a. Kandidati për anëtar i Komitetit Drejtues duhet:
    - i. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri,
    - ii. Të ketë arsim të lartë,





- iii. Të ketë figurë të pastër morale,
  - iv. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë Shqiptare dhe të huaja.
  - v. Të mos jetë i dënuar nga një Federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare,
  - vi. Të jetë i propozuar nga një anëtar i Federatës (klub sportiv apo shoqatë anëtare),
  - vii. Të ketë marrë pjesë në aktivitetet sportive, si sportist apo trainer i karatesë.
3. Anëtarët që e propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
  4. Emrat e kandidatëve, bashkë me kurrikulumin e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët në Sekretariatën e Përgjithshëm të FSHK. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet Komitetit Drejtues për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet delegatëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për ketë veprimtari Komiteti Drejtues duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut.
  5. Një anëtar i FSHK nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për anëtar të Komitetit Drejtues.

#### NENI 25

#### KOHËZGJATJA E MANDATEVE

1. Mandati i Presidentit, Zv/presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Drejtues ka një afat 4 vjeçar. Ata kanë të drejtë të rikandidojnë.
2. Komiteti Drejtues plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të tij në mbledhjen e Asamblesë së rradhës, nëpërmjet votimit, siç parashikohet në Statut për zgjedhjet e FSHK.

#### NENI 26

#### MBLEDHJET

1. Komitetit Drejtues mbledhet të paktën 4 herë në vit.
2. Mbledhja drejtohet nga Presidenti.
3. Presidenti bën njoftimin për mbledhje. 1/3 e anëtarëve të K.D. i kërkojnë Presidentit mbledhjen e K.D. jashtë rradhe. Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tre) javësh, pas marrjes së kërkesës.
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e K.D. pa të drejtë vote.
5. Mbledhjet e K.D. nuk mbahen në publik. K.D. mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHK.



6. Për mbledhjet e K.D. mbahet proces-verbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo anëtar i K.D., pjesëmarrës në mbledhje, si dhe vendimet duhet të zbardhen brenda 5 ditëve mbas shpalljes së tyre.
7. Proces-verbali i mbledhjeve ruhet në arkiv, në 2 (dy) kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e tij, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.

#### NENI 27

### KOMPETENCAT E KOMITETIT DREJTUES

1. K.D. ka këto kompetenca:

- a. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHK;
- b. Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive;
- c. Të planifikojë për secilin punonjës të FSHK specifikat e punës;
- d. Të monitorojë administrimin e FSHK;
- e. Të zgjedhë zv/presidentin;
- f. Të përgatisë dhe të mbajë Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme;
- g. Të hartojë projekt-buxhetin;
- h. Të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e organeve gjyquese;
- i. Të emërojë dhe, kur e sheh të arsyeshme, të shkarkojë anëtarët e Komisioneve të përhershme;
- j. Të përcaktojë, organizojë dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit Kombëtar dhe ndërkombëtar (këto të fundit, me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin);
- k. Të mbajë lidhje me organizatat sportive kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfshirë këtu klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FSHK për t'u zgjedhur në këto organizata.

#### NENI 28

### KUORUMI DHE VENDIMARRJA

1. K.D. zhvillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. K.D. merr vendime me 50% + 1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta, Presidenti ka votë vendimtare, kur votimi është i hapur.
3. Në rast se një anëtar i K.D. ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet, ai përjashtohet nga debati dhe votimi mbi këtë çështje.
4. Vendimet e marra regjistrohen në proces-verbal.
5. Vendimet e marra nga K.D. hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur K.D. vendos ndryshe.





## KREU VI SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

### NENI 29 SEKRETARI I PERGJITHSHEM

1. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FSHK.
2. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet nga K.D. për shkelje të rënda statutore, apo abuzime të ndonjë natyre tjetër.
  - a. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet:
    - i. Të jetë shtetas Shqiptar, me banim në Shqipëri;
    - ii. Të ketë arsim të lartë;
    - iii. Të ketë figurë të pastër morale;
    - iv. Të mos jetë dënuar nga organet e drejtësisë Shqiptare dhe të huaja;
    - v. Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegji, etj.)
    - vi. Të mos jetë dënuar nga një Federatë sportive për thyerje disipline, përdorim doping apo për abuzime financiare;
3. Funkcionet e tij janë:
  - a. Të kërkojë nga organet e Federatës zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave, Ligjit për Sportin dhe Vendimeve apo udhëzimeve të Ministrisë përgjegjëse për Sportin.
  - b. Të zbatojë vendimet e K.D.
  - c. Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve të FSHK.
  - d. Të programojë rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme dhe të mbledhjeve të K.D.
  - e. Të mbajë korrespondencën e FSHK.
  - f. Të mbajë librat e llogarisë së FSHK.
4. Sekretari i Përgjithshëm është drejtues i Sekretariatit të FSHK.
5. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionet e Sekretariatit të përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brenda tij.
6. Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, mbledhjet e K.D. dhe në ato të Komisioneve, me një rol këshillues. Nëse ai nuk është në gjendje të marrë pjesë, duhet të caktojë një zëdhënës.
8. Të informojë strukturat përkatëse shtetërore për mirëmenaxhimin e grantit, financimeve apo lehtësimeve fiskale që bën shteti për FSHK.



**NENI 30**  
**PËRJASHTIMI I NJË PERSONI TË ZGJEDHUR**

1. K.D. mund të pezullojë një anëtar të K.D. për shkelje statutore, abuzime financiare të faktuara nga organi kompetent apo për ndonjë shkelje apo veprim tjetër që K.D. e çmon si ngjarje të rëndësishme.
2. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që të përjashtojë një anëtar, kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve të plotë që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të FSHK.
3. Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përgjithshme kërkon përjashtimin e Presidentit për një arsye të paraqitur në mocionin e mosbesimit, Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin për të marrë vendimin ose jo të përjashtimit, kur ky propozim votohet me 2/3 e anëtarëve të numrit të përgjithshëm që përbëjnë asamblenë.
4. Mocioni i paraqitur nga 1/3 e anëtarëve, për çfarëdo lloj problemi qoftë ai, është detyrues për K.D. të Federatës për të mbledhur Asamblenë e Përgjithshme.

**KREU VII**  
**FINANCAT**

**NENI 31**  
**PERIUDHA FINANCIARE**

Periudha financiare për FSHK do të jetë viti kalendarik.

**NENI 32**  
**BURIMET FINANCIARE, SPONSORIZIMET DHE REKLAMIMET**

1. Të ardhurat e Federatës Shqiptare të Karatesë sigurohen nga:
  - a) Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit përgjegjës për Sportin. Ministria përgjegjëse për Sportin mbikqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit, në të gjitha Organizatat Sportive që kanë përfituar nga fondet publike;
  - b) Regjistrimet vjetore të anëtarëve;
  - c) Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHK;
  - d) Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara;





- e) Nga licensimi i trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, specialistëve, amatorëve, etj.;
  - f) Nga kuotat e anëtarësimit në Federatën Shqiptare të Karatesë.
2. Klubet sportive ose sportistët e Karatesë, në përputhje edhe me rregulloret e FSHK, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv, gjithmonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit, FSHK ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen në përputhje me Kodin Civil dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës dhe me aktet ligjore në fuqi.
3. Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

## KREU VIII SPORTISTI, KATEGORITË E SPORTISTËVE, TRAJNERI

### NENI 33 SPORTISTI

1. Sportisti i karatesë ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre dhe rregulloret e përcaktuara nga F.SH.K.
2. Pjesëmarrja e sportistit të karatesë në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin në fuqi. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi.
3. Transferimi i sportistit të karatesë nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive të miratuara nga F.SH.K dhe nga Federata Ndërkombëtare e Karatesë.

### NENI 34 KATEGORITË E SPORTISTËVE

1. Sportistët ndahen në amatorë dhe profesionistë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret e F.SH.K.
2. Sportistë amatorë të karatesë janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e karatesë dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën sportive ku janë regjistruar.



3. Sportistët profesionistë të karatesë janë ata persona që praktikojnë sportin e karatesë si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.

#### NENI 35

#### STATUSI I SPORTISTIT TË NIVELIT TË LARTË

Sportistët e karatesë të cilët përfitojnë statusin e nivelit të lartë në përputhje me Ligjin për Sportin, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: “rekord olimpik”, “rekord botëror”, “rekord europian”, “vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike”, “vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate botërore” dhe “vendi i parë deri në të tretin në kampionate europiane” dhe “vendi i parë në Lojërat Mesdhetare”. Në veprimtari kombëtare zyrtare: “sportisti i cili thyen rekordin kombëtar” dhe “vendi i parë në kampionatin kombëtar”.

#### NENI 36

#### TRAJNERI

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive anëtare të F.SH.K duhet të punësojnë trajnerë të licensuar nga F.SH.K dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe F.SH.K, kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtejshëm të trajnerëve në bashkëpunim me institucione përkatëse të fushës.

#### NENI 37

#### DETYRIMET E SPORTISTIT DHE TRAJNERIT

1. Sportisti i karatesë duhet të respektojë rregullat e F.SH.K dhe të Federatës Ndërkombëtare të Karatesë, parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë së karatesë.
2. Trajnerët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e F.SH.K.





**KREU IX**  
**ANTIDOPINGU, KONTROLLI MJEKËSOR NË SPORT DHE SIGURIMI**  
**SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE**

**NENI 38**  
**PËRDORIMI I SUBSTANCAVE DHE METODAVE DOPING**

1. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive të sportit të karatesë është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.
2. Lista e substancave dhe metodave *doping* të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
3. Përdorimi i substancave dhe metodave *doping*, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga F.SH.K.

**NENI 39**  
**DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME DOPINGUN**

1. F.SH.K. njih dhe merr përsipër të zbatojë sanksionet mbi Antidopingun dhe Feminitetin, konform rregullores së Federatës Ndërkombëtare të Karatesë në këtë fushë.
2. F.SH.K. njih autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping në ushtrimin e kontrolleve *antidoping* me sportistët anëtarë të F.SH.K.
3. F.SH.K. dhe të gjithë organizatat sportive anëtare të saj, pranojnë masat disiplinore dhe dënimet e dhëna nga Organizata Kombëtare Antidoping dhe Federata Ndërkombëtare e Karatesë për sportistët anëtarë të F.SH.K. që rezultojnë *pozitiv* në këto kontrolle.
4. F.SH.K. dhe Organizata Kombëtare Antidoping, si dhe të gjitha organizatat sportive të karatesë anëtare të F.SH.K. janë të detyruara të respektojnë Antidopingun sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport 2005”, dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989”.

**NENI 40**  
**KONTROLLI MJEKËSOR NË SPORT**

1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në F.SH.K dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj, pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e karatesë të anëtarësuar në F.SH.K pajisen me kartelë mjekësore vetjake.





2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licensuar, të paktën një herë në 6 muaj, për matjen e parametrave jetësorë.
3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare të karatesë bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.
4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.

#### NENI 41

### SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTËVE

1. Anëtarët e F.Sh.K., janë përgjegjës për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive të karatesë.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Anëtarët e F.SH.K, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive të sportistëve të karatesë të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohen të paguajnë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit, në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. F.SH.K është përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare të karatesë.

#### KREU X

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË FUNDIT

#### NENI 42

### DREJTESA SPORTIVE

Komisioni i Disiplines së F.Sh.K. shqyrton dhe vendos masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës të F.Sh.K. Vendimet e Komisionit të Disiplinës mund të ankimohen Këshillin e Arbitrazhit Sportiv brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

#### NENI 43

### DISPOZITA TE FUNDIT



1. Për çështje që nuk parashikohen në këtë Statut ose për çështje të forcave madhore zgjidhja do të bëhet duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.97/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, Kodit Civil, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” të ndryshuar, Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” të ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të F.SH.K, përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente, miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për Sportet.
3. Në rast mosmarrëveshesh brenda F.SH.K., të cilat çojnë në paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së F.SH.K., Ministri përgjegjës për Sportin ka të drejtë të pezullojë veprimtarinë e organeve drejtuese të F.SH.K. dhe të emërojë me mandat të përkohshëm një kryetar të F.SH.K për të drejtuar veprimtarinë e kësaj federate dhe për të përgatitur thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore.

**NENI 44**  
**HYRJA NË FUQI**

Ky Statut i F.SH.K hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Ministria përgjegjëse për Sportin dhe me depozitimim e tij në Gjykatën kompetente të Tiranës. Me hyrjen në fuqi, statuti zëvendëson çdo statut tjetër të mëparshëm.

*Erikela Ismajli*  
*[Signature]*



*[Signature]*  
*[Signature]*

